

Kompetencat e Dhomës së Posaçme, sipas nenit 5 të [Ligjit nr. 06/L-086](#) për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përfshijnë procedurat për fushat si më poshtë

- 1.1. kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- 1.2. kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë të cilat rrjedhin nga dështimi apo refuzimi i AKM-së apo Agjencisë për të kryer një akt apo për të përmbushur një obligim që kërkohet me ligj apo kontratë;
- 1.3. kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë për humbjet financiare që pohohen të jenë shkaktuar nga një vendim a veprim i ndërmarrë nga AKM-ja apo Agjencia, në bazë të autoritetit administrativ të përcaktuar me Rregulloren e AKM-së apo Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në lidhje me një Ndërmarrje apo Korporatë;
- 1.4. kërkesa kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së, apo Agjencisë;
- 1.5. kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me:
 - 1.5.1. çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ;
 - 1.5.2. pronësinë e një Ndërmarrjeje apo Korporate;
 - 1.5.3. pronësinë mbi kapitalin e një Ndërmarrjeje apo Korporate, ose
 - 1.5.4. çfarëdo prone apo pasurie në posedim apo kontroll të një Ndërmarrjeje apo Korporate, nëse një e drejtë, titull apo interes i tillë pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së apo Agjencisë;
- 1.6. kërkesa apo ankesa që kundërshtojnë apo sfidojnë cilindo aspekt të një liste zyrtare të punëtorëve me të drejtë legjitime të një Ndërmarrjeje, lëshuar nga AKM-ja apo Agjencia, sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo legjislacionit pasardhës që rregullon përpilimin e listave të tilla;
- 1.7. kërkesa në lidhje me likuidimin e një Ndërmarrjeje, që është kryer nga AKM-ja në bazë të Rregullores së AKM-së, apo nga Agjencia në bazë të Ligjit mbi AKP;
- 1.8. parashtrësia e bërë nga AKM-ja apo Agjencia në bazë të nenit 21 të Shtojcës

së Ligjit mbi AKP-në, për anulimin e një transaksioni të një Ndërmarrjeje që i është nënshtruar apo që i nënshtrohet likuidimit nga AKM-ja apo Agjencia.

- 1.9. ushtrimi i të drejtës apo autoritetit të AKM-së apo Agjencisë, nëse AKM-ja apo Agjencia ka parashtruar një parashtresë në Dhomën e Posaçme për të kërkuar një ushtrim të tillë, duke përfshirë këtu padi apo kërkesa të ushtruara nga Agjencia kundrejt palëve të tjera, qoftë në kapacitetin e saj si subjekt juridik, apo edhe gjatë ushtrimit të autoritetit të saj administrativ mbi një Ndërmarrje apo Korporatë;
- 1.10. rasti apo procedura që del brenda fushëveprimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 apo legjislacionit pasardhës së saj, apo një ankesë apo procedurë që është në lidhje me një rast brenda fushëveprimit të kësaj rregullore apo legjislacionit pasardhës së tij.
- 1.11. çdo parashtresë për vlerësimin dhe vendosjen e ligjshmërisë së një Aktgjykimi apo Aktvendimi të lëshuar nga një gjykatë tjetër në Kosovë në lidhje me kërkesat apo lëndët e përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni;
- 1.12. të gjitha lëndët tjera që mund t'i parashtrohen Dhomës së Posaçme sipas ligjit.